



Datë: 07.03.2025
Numër Protokolli: 3127/2025

A.nr.60/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.60/2025, të datës 10.01.2025, të parashtruar nga ankuesi Y.D kundër organit të punësimit: Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.60/2025, e datës 10.01.2025, e parashtruar nga ankuesi Y.D, ashtu që, **anulohet** Vendimi Ref: 01870/24, i datës 12.12.2024, i Komisionit Disiplinor, në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, ndërsa, çështja kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosje** te organi i njëjtë.
- II. **Obligohet** Drejtori Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, dhe në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi , të bëjë plotësim ndryshimin e përbërjes së Komisionit Disiplinor, përgjegjës vetëm për trajtimin e çështjes disiplinore të ankuesit.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil Y.D (*tani e tutje vetëm ankuesi*), më datë 10.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.nr.01870/24, të datës 12.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës (tutje AKKVP), ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.01.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 106/2025 të datës 10.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit Ref.nr.01870/24, të datës 12.12.2024, të Komisionit Disiplinor të AKKVP-së; Fletëngarim i mallit me Nr. 1200/2024 i datës 08.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1179/2024 i datës 07.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1202/2024 i datës 08.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1207/2024 i datës 08.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1209/2024 i datës 08.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1193/2024 i datës 07.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 140/2024 i datës 22.03.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 123/2024 i datës 22.03.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1101/2024 i datës 18.07.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 133/2024 i datës 03.05.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 129/2024 i datës 28.03.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 132/2024 i datës 28.03.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1159/2024 i datës 29.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1158/2024 i datës 29.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1146/2024 i datës 08.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1148/2024 i datës 25.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1154/2024 i datës 25.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1155/2024 i datës 25.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1142/2024 i datës 25.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1152/2024 i datës 25.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1135/2024 i datës 23.10.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1173/2024 i datës 06.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1178/2024 i datës 07.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1180/2024 i datës 07.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1188/2024 i datës 07.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1192/2024 i datës 07.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1260/2024 i datës 19.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1169/2024 i datës 19.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1271/2024 i datës 29.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1267/2024 i datës 19.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1265/2024 i datës 19.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1266/2024 i datës 19.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1238/2024 i datës 14.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1162/2024 i datës 18.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1261/2024 i datës 19.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1248/2024 i datës 18.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1244/2024 i datës 18.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1099/2024 i datës 22.04.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 130/2024 i datës 28.03.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1197/2024 i datës 08.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1305/2025 i datës 08.01.2025; Fletëngarim i mallit me Nr. 1303/2025 i datës 08.01.2025; Fletëngarim i mallit me Nr. 1304/2025 i datës 08.01.2025; Fletëngarim i mallit me Nr. 1301/2025 i datës 08.01.2025; Fletëngarim i mallit me Nr. 1299/2024 i datës 26.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1297/2024 i datës 26.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1298/2024 i datës 26.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1294/2024 i datës 16.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 227/2024 i datës 16.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1292/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1285/2024 i datës 22.11.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 212/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1290/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 222/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1291/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 223/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1293/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 225/2024 i datës 09.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 1289/2024 i datës 06.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 220/2024 i datës 06.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 215/2024 i datës 05.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 216/2024 i datës 05.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 219/2024 i datës 05.12.2024; Fletëngarim i mallit me Nr. 218/2024 i datës 05.12.2024; Faturë e Shitjes 2024-391 e datës 29.07.2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 22.01.2025; Akt Emërimit e datës 12.01.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Asistent i Lartë Administrativ; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 05.11.2024; Njoftimin për seancë të Komisionit Disiplinor për ankuesin e datës 07.11.2024; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 12.12.2024, 07.11.2024 dhe 18.11.2024; Vendim për pushim vjetor i datës 27.02.2024; Emailin e datës 03.10.2024 nga ankuesi për K.H; Emailin e datës 30.09.2024 nga K.H për ankuesin; Shkresë për të gjeturat dhe rekomandimet për raportin e auditimit në AKKVP-së; Vendimin Ref: 01056/24/sa për emetimin e Komisionit

Disiplinor; Raportin vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm i datës 31.03.2024; Emailin e datës 08.10.2024 nga A.B për A.B; Emailin e datës 01.11.2024 nga K.H për A.B; Listat e ngarkimeve; Emaili i datës 11.11.2024 nga B.L për ankuesin; Emailin e datës 14.11.2024 nga ankuesi për A.K; Emailin e datës 14.11.2024 nga ankues për M.K; Raportin për procesin e Inventarizimit të Pasurive jo financiar 2023 i datës 29.11.2023; Listën e aseteve të pagjetura gjatë procesi të inventarizimit; Listën e regjistrit të pasurive AKKVP; Emailin e datës 18.01.2024 nga A.P për A.B me listën e aseteve të pagjetura; Lista pa barkode nga komisioni 2023; Lista e aseteve të tjetërsuara; Lista e aseteve të gjetura të dëmtuara; Plani i veprimit për adresimin e dobësive të identifikuara të SKB-së dhe rekomandimeve të auditorëve; Emailin e datës 21.01.2025 nga M.R për A.B dhe ankuesin Emailin e datës 15.01.2025 nga A.B për M; Emailin e datës 15.01.2025 nga M.R për A.B; Emailin e datës 14.01.2025, 10.01.2025 nga M.R për ankuesin; Vendimin e datës 21.02.2025 për vazhdimin e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të çështjes vlerësoj që lënda të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje** tek Komisioni Disiplinor i AKKVP-së, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi është i punësuar në AKKVP dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 12.01.2012, mbanë pozitën e punës Asistent i Lartë Administrativ, Zyra e Pranimi të Mallit.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se Drejtori Ekzekutiv i AKKVP-së, më datë 05.11.2024, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, për shkak të dyshimit për shkeljeve të rënda të detyrave të punës, gjegjësisht, mos përmbushjes të detyrave të punës, neglizhencë e vazhdueshme në përmbushjen e detyrave të punës dhe mos respektim i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës. E gjithë kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore bazohet në gjetjet e Raportit të Auditimit të Brendshëm të datës 12.03.2024.

Komisioni Disiplinor i AKKVP-së më Vendimin Ref: 01870/24 të datës 12.12.2024, ka shpall përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafët 4.1 4.2 dhe 4.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore *“transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë”*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Ref.nr.01870/24, të datës 12.12.2024, të Komisionit Disiplinor të AKKV-së, duke pretenduar së vendimi i atakuar është përcjell me shkelje procedurale dhe materiale, sepse përbërja e Komisionit Disiplinor ka qenë e kundërligjshme ngase anëtari i komisionit A.B ka qenë pjesë e komisionit disiplinor, dhe se i njëjti ka marrë pjesë në përgatitje të raportit të inventarizimit të pasurive jo financiare për vitin 2023 dhe si rezultat i kësaj vihet në dyshim paanshmëria e tij, sepse nuk mund të jetë edhe anëtar i Komisionit Disiplinor dhe anëtar i Komisionit të Inventarizimit. Shton se Komisioni Disiplinor ka dështuar të argumentoj faktet lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, dhe se i njëjti fare nuk ka trajtuar argumentet e paraqitura nga ankuesi të cilat e argumentojnë atë që ankuesi nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore. Kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë dhe të obligohet AKKVP që ta kthej në pozitën e mëparshme.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, më theks të veçantë:

- Nenit 55: “1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.

- Nenit 56: “1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: **4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.**

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit analizoj aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje më pretendimet ankimore si në ankesë dhe provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka gjetur së sipas Vendimit Ref: 01056/24/sa, të datës 22.07.2024, të Drejtores së Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP-së, është themeluar Komisioni Disiplinor i AKKVP-së në përbërje: P.B-kryetar, A.B dhe S.A. Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton së zyrtari A.B kishte qenë e pjesë edhe e Komisionit për Procesin e Inventarizimit të Pasurive jo Financiare për vitin 2023, Komision ky që më datë 29.11.2023, ka finalizuar dhe nënshkruar Raportin për Procesin e Inventarizimit të Pasurive jo Financiare për vitin 2023, akt mbi bazën e të cilit edhe janë dhënë konstatimet dhe te gjeturat e Auditorit të Brendshëm përmes raportit të auditimit për vitin 2023, i përfunduar më 21.02.2024.

Andaj, mbi bazën e faktit së zyrtari A.B ka qenë njëkohësisht anëtar i Komisionit për Procesin e Inventarizimit të Pasurive jo Financiare për vitin 2023 dhe anëtar i Komisionit Disiplinor, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit kjo rrethanë përben shkak për përjashtimin e tij nga procedura disiplinore e ankuesit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 29 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata: 1.7. nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vetë atij, ose nga personat e përmendur në nën paragrafin 1.2 të këtij neni; 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij”,

gjegjesisht, zyrtari A.B në rastin e veprimit si anëtar i Komisionit Disiplinor në shqyrtimin e çështjes disiplinore të ankuesit duhej të inicioje veprime sikurse përshihet me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: “Kur gjendet apo dyshon se është në një situatë sipas nenit 29 të këtij Ligji, nëpunësi apo anëtar i organit kolegjal, menjëherë me njohjen e shkakut, tërhiqet nga pjesëmarrja në procedurën administrative dhe njofton eprorin e vet gjegjesisht organin kolegjal”,

Kolegji i Këshillit në trajtimin e kësaj çështje disiplinore mori parasysh edhe përcaktimet sipas nenit 10 paragrafi 5 dhe 6 si dhe nenit 13 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: **Neni 10“5.** Në rast kur kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti i interesit paraqitet ndërkohë, ata zëvendësohen nga drejtuesi më i lartë i institucionit për raste si në vijim: 5.1. kur kryesuesi apo anëtar i komisionit është në pozitë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ndaj shkelësit të dyshuar apo anasjelltas; 5.2. kur kryesuesi apo anëtar i komisionit ka qenë i dëmtuar nga shkelësi i pretenduar; 5.3. kur kryesuesi apo anëtar i komisionit me shkelësin e pretenduar plotësojnë kushtet e parapara në LPPA për rastet e përjashtimit nga procedura. 6. Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor zbatohen dispozitat e LPPA-së... **Neni 13 6.** Procedura dhe vendimmarrja zhvillohet në përputhje me ligjin përkatës për procedurën administrative”.

Nisur nga rrethanat dhe konstatimet si me sipër, dhe më qëllim të kthimit të ligjshmërisë, Kolegji i aprovoj ankesën dhe vendosi që çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i AKKVP-së, me detyrimin që Drejtori Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, të bëjë plotësim ndryshimin e përbërjes së Komisionit Disiplinor përgjegjës vetëm për trajtimin e çështjes disiplinore të ankuesit, ashtu që, anëtar A.B të zëvendësohet me një anëtar tjetër (ad hoc), ndërsa, Komisioni disiplinor duhet të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga se u tha si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.60/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Y.D;
- Organit të punësimit: Drejtores Ekzekutive, Komisionit Disiplinor dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në AKKVP;
- Arkivit të KPMSHCK-së.